



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-48/1 datë 05.01.2021, me pretendime të pakënaqësisë me veprimet e institucioneve dhe procedurat gjyqësore të zhvilluara në lidhje me kontestin pronëso- juridik në -----
HODHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se sipas dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin, dhe lënda do t'i dërgohet Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lënda me numër 12-48/1 të datës 05.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 05.01.2021, është dorëzuar një kërkesë e regjistruar me numër 12-48/1, datë 05.01.2021 me pretendime për pakënaqësi me veprimet e institucioneve dhe procedurat gjyqësore të zhvilluara në lidhje me një mosmarrëveshje pasurore-juridike të familjes së parashtruesit. Ndaj denoncimit është dorëzuar edhe plotësim, i regjistruar me numrin 12-48/1 nga data 26.01.2021. Në rastin konkret bëhet fjalë për një padi të ngritur nëpërmjet avokatit ----- nga ----- si përfaqësues i autorizuar i parashtruesit të denoncimit dhe procedurave gjyqësore të mbajtur kundër Aktvendimit për privatizim të tokës ndërtimore të miratuar më 30.09.2011 nga Administrata për Çështje Pronësore dhe Juridike - Departamenti për Procedurë Administrative ----- dhe Vendimi i datës 04.05.2022 të Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në procedurën administrative dhe procedurën e punësimit në shkallën e dytë.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja thekson se nga pretendimet e denoncuar nuk rezulton se interesi publik është i kërcënuar nga zyrtarët në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, në rastin në fjalë kanë vepruar institucionet kompetente dhe autoritetet gjyqësore. si dhe ka aktvendime gjyqësore, dhe veprimet e denoncuar nuk janë aktivitete për të cilat KSHPK-ja ka kompetencë të veprojë, por janë aktivitete për të cilat autoritete të tjera kompetente kanë autoritet të veprojnë. KSHPK-ja konstatoi se sipas dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin, dhe lënda do t'i dërgohet Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Нёнкрыетар,
Нури Бајрамй

Dorёzuar deri te: Parashtruesi i denoncimit
Pёrgatiti: J.C.
Miratoi: NB, anёtar i KSHPK - sё

